



AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENCËS
AUTORITET KOSOVA ZA KONKURENCIJU
KOSOVO COMPETITION AUTHORITY

GJOBAT PËR SHKELJE TË LIGJIT KOSOVAR TË KONKURENCËS

SIGURIMI I PËRFITIMEVE NGA
KONKURRENCA E DREJTË

10



Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
Autoritet Kosova za Konkurenciju
Kosovo Competition Authority

**SIGURIMI I PËRFITIMEVE NGA
KONKURRENCA E DREJTË (Broshura Nr.10)**

***GJOBAT PËR SHKELJE TË LIGJIT
KOSOVAR TË KONKURRENCËS***

Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (të ndryshuar)¹, ka hapësirë për zbatim të gjobave (nganjëherë gjoba shumë të rënda) për një varg shkeljesh të rregullave të konkurrencës bazuar në vendimet e Komisionit Kosovar të Konkurrencës² dhe të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës³.

Për shkelje të mëdha të rregullave të konkurrencës, mund të vendosen gjoba deri në 10% të qarkullimit vjetore të fundit një ndërmarrjeje e cila konsiderohet se është në shkelje të rëndë të Ligjit. Kur ajo ndërmarrje është pjesë e një grupi më të gjerë ndërmarrjesh të përfshira gjithashtu në shkelje, qarkullimi vjetor më i fundit i atij grupi mund të përdoret për qëllimet e caktimit të gjobës.

Shkeljet më serioze të Ligjit kanë të bëjnë me: pjesëmarrjen në një kartel, të qenit palë në një marrëveshje të ndaluar, zbatimin e një përqendrimi të ndaluar dhe abuzimin me një pozitë dominuese në tregun e Kosovës⁴. Gjithashtu, gjoba më të vogla parashikohen në raste të tilla si mosdhënia e informacionit të kërkuar nga Autoriteti ose dhënia e informacionit të rremë ose mashtrues⁵. Gjodat llogariten na baza të rast pas rastit, si dhe marrin parasysh, sidomos, rrethanat rënduese ose rrethanat lehtësuese relevante për shkeljen⁶.

Rrethanat rënduese zakonisht përfshijnë çështje të tilla si shkelje të përsëritura, pengim ndaj hetimit të Autoritetit dhe nëse një ndërmarrje e caktuar ka qënë udhëheqësja ose shtytësja e shkeljes. Rrethanat lehtësuese kanë të bëjnë me çështje të tilla si ndalja e parakohshme e një shkeljeje, përfshirja e kufizuar në

¹ Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës (Nr. 03 / L-220) i vitit 2010 i ndryshuar me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (Nr. 04 / L-226) të vitit 2014.

² Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës (i ndryshuar), Neni 28.

³ Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës (i ndryshuar), Neni 54.

⁴ Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës (i ndryshuar), Neni 56.

⁵ Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës (i ndryshuar), Neni 57.

⁶ Këto konsiderata trajtohen në Nenet 59 dhe 60 të Ligjit si dhe metodologjia për caktimin e gjobave është e shtjelluar më tej në Udhëzimin Administrativ Nr. 1/2018 të Autoritetit mbi kriteret për vendosjen e masave të sanksionit administrativ. Kjo metodologji është në përputhje me rregullat e ngjashme të BE-së.

shkelje, bashkëpunimi me një hetim të Autoritetit përtej fushëveprimit të një marrëveshjeje për lehtësime⁷, nëse shkelja është ose duket se është e autorizuar nga ligji ose nga një autoritet publik dhe kur ka ekzistuar dyshimi i arsyeshem se ka ndodhur një shkelje.

Gjobat nuk mund të vendosen në lidhje me një shkelje të Ligjit e cila ka ndodhur më shumë se 5 vite para konstatimit të shkeljes⁸. Për më tepër, një gjobë për shkelje të Ligjit është një dënim administrativ (dhe jo një ndëshkim penal)⁹.

Dënimet për shkeljet e Rënda

Neni 56 i Ligjit parashikon gjoba deri në 10% të qarkullimit vjetor më të fundit të një ndërmarrjeje nëse konstatohet se:

- ka bërë një marrëveshje të ndaluar ose në ndonjë mënyrë tjetër ka marrë pjesë në një marrëveshje ose praktikë të bashkërenduar e cila ka prishur konkurrencën¹⁰;
- ka abuzuar me pozitën e saj dominuese në treg¹¹;
- ka marrë pjesë në zbatimin e një përqendrimi të ndaluar të ndërmarrjeve¹²; ose
- nuk ka vepruar në përputhje me një vendim të Autoritetit i cili urdhëron masa për rivendosjen e konkurrencës në treg ose që shqipton masa të përkohshme.

⁷ Shikoni broshurën në këtë seri të broshurave, Programi i Lehtësimeve i AKK-së. Programi është i autorizuar sipas Nenit 60 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (i ndryshuar) dhe shtjelluar më tej në Udhëzimin Administrativ Nr. 7/2012 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për kriteret për të përjashtuar ose zvogëluar një sanksion administrativ..

⁸ Shih Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës (i ndryshuar), nenet 64 dhe 65 (Parashkrimi).

⁹ Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës (i ndryshuar), Neni 60(5).

¹⁰ Një Shkelje e nenit 4 të Ligjit.

¹¹ Një Shkelje e nenit 11 të Ligjit.

¹² Një Shkelje e nenit 14 të Ligjit.

Dënimet për shkeljet e lehta

Neni 56 i Ligjit parashikon gjoba deri në 2% të qarkullimit vjetor më të fundit të një ndërmarrje nëse konstatohet se:

- nuk ka arritur të paraqesë në një njoftim të kërkuar për përqendrim tek Autoriteti¹³;
- ka paraqitur informacion të pasaktë ose të rremë tek Autoriteti në një procedurë të vlerësimit të përqendrimit;
- nuk ka vepruar në përputhje me kërkesën e Autoritetit për të furnizuar informacion gjatë një hetimi të konkurrencës¹⁴; ose
- ka parandaluar ekzekutimin e një urdhri të Gjykatës në lidhje me një inspektim të pa-paralajmëruar¹⁵.

Për shkak të rëndësisë së bashkëpunimit të biznesit me Autoritetin në hetimet e tij, mund të vendosen gjithashtu gjoba që variojnë nga 1,000 € deri në 3,000 € për ndërmarrjet që nuk e kanë statusin e palës në një procedurë hetimi dhe të cilat nuk veprojnë në përputhje me një kërkesë të Autoritetit për informacion në lidhje me një hetim¹⁶.

Gjobat për menaxherët/drejtuesit e biznesit

Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës (i ndryshuar) parashikon gjithashtu, vendosjen e gjobave që variojnë nga 1,000 € në 3,000 € për personin përgjegjës për një ndërmarrje ose një organ shtetëror nëse ai ose ajo është përfshirë në një shkelje të rëndë ose të lehtë të ligji¹⁷.

¹³Një Shkelje e nenit 22(1) të Ligjit.

¹⁴Shkelja e nenit 38(1) dhe (3) të Ligjit.

¹⁵Shikoni nenet 39 deri 43 të Ligjit dhe broshurën në këtë seri të tyre për Procedurat e Hetimit të Konkurrencës.

¹⁶Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës (i ndryshuar), Neni 58.

¹⁷Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës (i ndryshuar), Neni 57A.

Si llogariten gjobat

Nenet 59 dhe 60 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (të ndryshuar) përcaktojnë metodologjinë e përgjithshme për caktimin e gjobave për shkeljet e Ligjit. Këto dispozita shtjellohen më tej në Udhëzimin Administrativ Nr. 1/2018 të Autoritetit për kriteret për vendosjen e masave të sanksionit administrativ. Nga Autoriteti kërkohet që të justifikojë llogaritjen e gjobave të tij në çdo vendim që shqipton gjoba¹⁸.

Siç u shpjegua më lart, gjobat e korporatave për shkelje të Ligjit mund të shkojnë nga deri në 2% të qarkullimit vjetor më të fundit të një ndërmarrjeje për shkelje të lehta të Ligjit deri në 10% të qarkullimit vjetor më të fundit të një ndërmarrjeje për shkelje të rënda. Gjobat individuale, nga ana tjetër, mund të shkojnë nga 1,000 deri në 3,000 €.

Në fakt, llogaritja e gjobave lind në fazat e mëvonshme të procedurës së hetimit të Autoritetit, duke marrë parasysh natyrën e shkeljeve të gjetura nga hetimi, çdo faktor rëndues ose lehtësues që është shfaqur në lidhje me ndërmarrjet përkatëse si dhe metodologjinë specifike të Udhëzimit Administrativ Nr. 1/2018.

Përveç marrjes parasysh nga ana e tij të faktorëve lehtësues në lidhje me gjobat, Ligji parashikon gjithashtu që, Autoriteti mund të zvogëlojë shumën e një gjobe që do t'i shqiptohet një ndërmarrjeje shkelëse, nëse kjo e fundit është në një situatë të vështirë financiare dhe i ka siguruar Autoritetit provat relevante se gjoba e parashikuar do të dëmtonte në mënyrë të pakthyeshme qëndrueshmërinë ekonomike të saj dhe do të çonte në një humbje totale të vlerës së pronës së saj. Në një rast të tillë, Autoriteti mund të vendosë një "gjobë simbolike". Gjobat simbolike mund të vendosen gjithashtu kur Autoriteti është i kënaqur se, pavarësisht

¹⁸ Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës (i ndryshuar), Neni 59(11).

nga vërtetuar shkeljes, pengimi i tregut nuk ishte i domethënës apo nuk kishte efekte negative aktuale në treg¹⁹.

Në lidhje me pagimin e gjobave, afati dhe afatet e pagesës përcaktohen në vendimin përkatës të Autoritetit. Paguesa mund të lejohet me këste. Për më tepër, gjoba aktivizohet në momentin kur vendimi i Autoritetit hyn në fuqi nëse nuk është paraqitur ankesë. Nëse një ankese rezulton e pasuksesshme, Gjykata mund të shtojë një pagesë interesi e cila mbulon periudhën nga data e vendimit të Autoritetit deri në datën e pagesës përfundimtare të gjobës pas vendimit të Gjykatës²⁰.

Kur gjobat janë të papaguara, Autoriteti, në bashkëpunim me Administratën Tatimore të Kosovës, është i autorizuar të detyrojë pagesën si një çështje taksimi²¹.

¹⁹ Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës (i ndryshuar), Neni 59(7) dhe (8).

²⁰ Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës (i ndryshuar), Neni 63.

²¹ Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës (i ndryshuar), Neni 63(4).

Informacione të mëtejshme

Për informacione të mëtejshme, shihni broshurat e tjera në serinë e broshurave të AKK-së “***Sigurimi i përfitimeve nga Konkurrenca e Drejtë*** ” dhe vizitoni faqen tonë të internetit në: <https://ak.rks-gov.net/>



Funded by
the European Union



Kjo broshurë është përgatitur me ndihmën e Projektit të financuar nga BE: "Mbështetje e BE-së për Autoritetin Kosovar të Konkurrencës dhe Komisionin e Ndihmës Shtetërore" menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë dhe zbatuar nga një Konsorcium i B&S Europe

